



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPËRNDARJEN E KOSTOVE TË LIDHURA ME KOORDINIMIN E PUNIMEVE CIVILE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 15, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve në nenin 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

# **RREGULLA PËR SHPËRNDARJEN E KOSTOVE TË LIDHURA ME KOORDINIMIN E PUNIMEVE CIVILE**

## **Neni 1 Objekti**

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile.

## **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i këtyre rregullave është lehtësimi i kostove për ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike përmes koordinimit të punëve civile.

## **Neni 3 Parime të koordinimit të punimeve civile**

Koordinimi i punimeve civile në ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike bazohet në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe orientimit në kosto.

Koordinimi i punimeve civile për ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike bëhet mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar dhe pranohet në rastet kur ajo është e arsyeshme dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) nuk sjell kosto shtesë apo vonesa për fillimin e punimeve civile dhe nuk rrezikon kryerjen e punimeve, sipas afateve të lejes së ndërtimit;
- b) nuk pengon mbikëqyrjen e punimeve civile të koordinuara;
- c) kërkesa për koordinim bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e projektit final pranë autoritetit planifikues për dhënien e lejes së ndërtimit;
- ç) nuk cënon objektivat dhe funksionalitetin e investimit të operatorit të rrjetit;
- d) është në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon fushën e veprimtarisë së operatorit të rrjetit.

## **Neni 3 Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në ligjin Nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

## **Neni 4 Shpërndarja e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile**

Në rastin e pjesëmarrjes së më shumë se një operatori rrjeti në punimet civile për ndërtimin e rrjetit/eve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, kostot për punimet civile ndahen në mënyrë përpjestimore midis pjesëmarrësve.

Në rastin kur punimet civile për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë kanë filluar nga një operator i rrjetit të infrastrukturave, me paraqitjen e kërkesës dhe pranimin e saj sipas parashikimeve në ligj për koordinimin e punimeve civile, të gjitha kostot/shpenzimet respektive për kryerjen e punimeve civile për shtrimin e rrjetit/eve respektive ndahen midis operatorëve pjesëmarrës sipas formulës:

$$K_i = \text{Kosto Totale} * P_i / n$$

“ $K_i$ ” është kosto që do paguajë operatori i “i-të”

$$\text{Kosto Totale} = k_1 + k_2 + \dots + k_i$$

Me “ $k_i$ ” janë shënuar elementet e kostove të punimeve civile (gërmim dheu, zhvendosje të dheut, kthim në gjendjen e mëparshme, kosto për elementet e mirëmbajtjes/puseta etj).

Me “ $n$ ” është shënuar numri i operatorëve pjesëmarrës në koordinimin e punimeve civile.

$P_i$  – Pesha specifike për secilin pjesëmarrës

Pesha specifike përcaktohet mbi bazën e përqindjes në volum të punimeve të secilit sipas natyrës, llojit dhe sasisë së elementeve që kërkon ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit përkatës të infrastrukturës.

## **Neni 5** **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast të mosmarrëveshjeve për koordinimin e punimeve civile, pala e interesuar i drejtohet autoritetit përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve në nenin 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit.